



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:030348

Datë: 13.09.2018

Numri i dokumentit: 00120527

**P. nr.696/17**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit T. Gj. nga fsh.B K.Gjakovë, për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP/II.nr.1307/17 të datës 20.10.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **13.09.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Enis Gashi, të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari **T. GJ.**, nga i ati L., e ëma L., e gjinisë F., data e lindjes .... në S. R.e Gjermanisë, e tani me banim në fsh.B K.Gjakovë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor-kuzhinjer, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë s h t ë f a j t o r:

**Sepse:** Me datën 29.08.2017 rreth orës 07.30 minuta në rrugën magjistrale Klinë-Gjakovë pikërisht në hyrje të fshatit L., rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 nenin 72 lidhur me nenin 55 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë sipas pasojë e veprimit apo mos veprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund të ndaloj shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “O. A.” me targë të regjistrimit ....., me ngjyrë të gjelbërt, duke mos ju përshtatur shpejtësinë, kushteve dhe rrethanave në rrugë hynë në tejkalim mes qerres me kali dhe traktorit dhe gjatë tejkalimit në pamundësi ta përfundoi në mënyrë të sigurt, me pjesën anësore të anës së majtë godet qerren me kali të cilën e drejtonte K. R., ndërsa me pjesën anësore të djathtë të automjetit e godet traktorin e markës “F.” të cilën e drejtonte B. S., pas goditjes automjeti humb kontrollin del jashtë rrugës në anën e djathtë duke u rrokullisur, kurse qerrja me kali rrotullohet në rrugë, ndërsa traktori del nga rruga në anën e

majtë në drejtim të lëvizjes, me ç' rast përpos dëmeve materiale në automjet vet i pandehuri T. Gj.si dhe të dëmtuarit K. R. dhe B. S. pësojnë lëndime të lehta trupore, lëndimet të konstatuar dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N. U. të dt.01.10.2017.

- me çka ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton;

### **DËNIM ME GJOBË:**

Dënim me gjobë në shumë prej **250.-(Dyqindpesëdhjetë)**Euro, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **12(dymbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00-€.(njëzet) euro, të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale në emër të ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej **51.1.-€**, në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumën prej **50,00 Euro**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit K. R. nga fsh.R.K.Gjakovë dhe B. S. nga fsh.B K.Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1307/17, të datës 20.10.2017,kundër të akuzuarit T. Gj.nga fsh.B K.Gjakovë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari T. Gj.lidhur me fajësinë në shqyrtimin fillestar deklaroi, se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem, për të cilën veprë jam penduar pa masë por premtoi para gjykatës se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, këtë veprë e kam kryer nga pakujdesia ime, shton se për herë të parë paraqitem në gjykatë për një veprë të kryer penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, njëherit shprehi keqardhje për lëndimet që i kanë marr të dëmtuarit, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari T. Gj.: Me datën 29.08.2017 rreth orës 07.30 minuta në rrugën magjistrale Klinë-Gjakovë pikërisht në hyrje të fshatit L., rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 nenin 72 lidhur me nenin 55 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë sipas pasojë e veprimit apo mos veprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund të ndaloj shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “O. A.” me targë të regjistrimit ....., me ngjyrë të gjelbërt, duke mos ju përshtatur shpejtësinë, kushteve dhe rrethanave në rrugë hynë në tejkalim mes qerres me kali dhe traktorit dhe gjatë tejkalimit në pamundësi ta përfundoj në mënyrë të sigurt, me pjesën anësore të anës së majtë godet qerren me kali të cilën e drejtonte K. R., ndërsa me pjesën anësore të djathtë të automjetit e godet traktorin e markës “F.” të cilën e drejtonte B. S., pas goditjes automjeti humb kontrollin del jashtë rrugës në anën e djathtë duke u rrokullisur, kurse qerrja me kali rrotullohet në rrugë, ndërsa traktori del nga rruga në anën e majtë në drejtim të lëvizjes, me ç’ rast përpos dëmeve materiale në automjet vet i pandehuri T. Gj.si dhe të dëmtuarit K. R. dhe B. S. pësojnë lëndime të lehta trupore, lëndimet të konstatuar dhe të përshkuara hollësisht në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N. U. të dt.01.10.2017.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtores dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-ës të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e tij ekonomike, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në gjykatë, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, mos dënushmërinë e tij të mëparshme, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata muar parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, në këtë aksident lëndime të lehta trupore kanë marrë të dëmtuarit, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të njëjtit të shqiptojë dënim me gjobë në shumë prej **250.- (dyqindë e pesëdhjete)** Euro, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe shpenzimeve të procedurës penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
Departamenti i përgjithshëm  
P. nr.696/17 më datë 13.09.2018**

**Sekretarja juridike,  
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:030348  
Datë: 13.09.2018  
Numri i dokumentit: 00120527